



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0811
Data e Vendimit: 11.09.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Olti” SH.P.K. kundër njoftimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT” me numër prokurimi 616-25-6970-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 11 .09.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e jashtëafatshme ankesa e OE “Olti” SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0811, e datës 25.08.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT” me numër prokurimi 616-25-6970-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 25.08.2025, ka pranuar ankesën e OE “Olti” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i shkollave dhe IEA -

BYFEJAT” me numër prokurimi 616-25-6970-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, në cilësi të AK-së.

Me 30.07.2025, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ku hapja e parë e ofertave është planifikuar të bëhet me datën 20.08.2025.

OE “Olti” SH.P.K me datën 05.06.2025 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndërkaq me datën 15.08.2025 AK ka refuzuar kërkesën e OE.

Operatori Ekonomik “Olti” SH.P.K me datën 25.08.2025, ka parashtruar ankesë në OSHP me numër protokolli 811/2025.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse me datën 20.08.2025 është planifikuar hapja e ofertave ndërsa OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar me datën 15.08.2025.

OSHP sqaron se kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Sipas nenit 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik, Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues është jashtë afatit ligjor, dhe jo ashtu siç është paraparë në nenin 60 paragrafi 1 pika a) të Rregullores për Prokurimin Publik pasi që kërkesa është parashtruar me 15.08.2025, në kundërshtim me nenin 108/A pika 3.1.

-Përfundim-

Autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT” me numër prokurimi 616-25-6970-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP tarifë kjo e cila kthehet konform nenit 31 par 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - OLTİ SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: